

Vendim nr. 215 datë 02.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 02.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (K) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: KOLË HYSENAJ

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së parimit të shqyrtimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së gjykatës në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, sipas neneve 42, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Konstatimi i shkeljes së parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe proporcionalitetit, në kuptim të nenit 142, pika 1, të Kushtetutës.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 2, 131, shkronjat “e” dhe “f” dhe 134, shkronja “i” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 49, shkronja “e”, 50, pika 4, 70, 71, shkronja “a” dhe 81, pika 3, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Kolë Hysenaj ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për rrjedhojë i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 84/2016).

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), në përfundim të hetimit dhe vlerësimit tërësor për kriterin e pasurisë, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me këtë kriter, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, sipas nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016. Vendimmarrja për këtë subjekt u vlerësua të bazohet vetëm në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e pasurisë. Për rrjedhojë, me vendimin nr. 368, datë 19.04.2021, KPK-ja ka vendosur: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kolë Hysenaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.*”.

3. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelitimit (KPA), duke kërkuar prishjen e vendimit të KPK-së dhe urdhërimin e saj për të vazhduar procesin e rivlerësimit edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilat nuk është arsyetuar në vendim, si dhe kalimin në seancë gjyqësore publike të kësaj çështjeje, ndryshimin e vendimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

4. KPA-ja, në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, me vendimin nr. 54, datë 19.12.2023, ka vendosur: “*1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 368, datë 19.04.2021 të KPK-së që i përket subjektit të rivlerësimit Kolë Hysenaj. 2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.*”.

5. Në datën 04.07.2024 kërkuesi Kolë Hysenaj i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 22.07.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mbështetje të kërkesës së tij, në mënyrë të përmblëdhur, ka parashtruar cenimin:

- 6.1. *E së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, e pavarur dhe e paanshme*, pasi disa komisionerë të KPK-së dhe disa gjyqtarë të KPA-së nuk plotësojnë kriteret ligjore për t'u emëruar në këto pozicione. Mosplotësimi i disa kriterëve në emërimin e tyre ka nxjerrë në pah edhe ndikimin që ka pasur pushteti ekzekutiv në krijimin e këtyre trupave gjyqësore. Përzgjedhja e disa komisionerëve dhe gjyqtarëve, respektivisht të KPK-së dhe KPA-së, mbi bazën e dokumentacionit që qartësisht nuk plotëson kriteret e ligjit tregon një sjellje që bie ndesh me integritetin, përgjegjshmërinë dhe transparencën që duhet të tregojë anëtari i një gjykate të caktuar me ligj, kjo jo si vullnet personal, por si një kriter ligjor përzgjedhës.
- 6.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi arsyetimi i KPA-së paraqitet kontradiktor dhe nuk u përgjigjet aspak pretendimeve të kërkuarit të paraqitura në ankim. Dispozita mbi të cilën është marrë masa e shkarkimit referon nevojën e përmbushjes kumulative të pamjaftueshmërisë për kriterin e pasurisë dhe figurës. Mungesa e arsyetimit të vendimit si nga KPK-ja, ashtu edhe nga KPA-ja e lë pa përgjigje ankimin e kërkuarit dhe njëkohësisht të paarsyetuar vendimin se si është arritur në konkluzionin për shkarkimin e tij nga detyra, kur për një nga kriteret e rivlerësimit mbi të cilin është marrë masa e shkarkimit nuk është dhënë konkluzioni përkatës. Vendimmarrja e këtyre organeve për shkarkimin nga detyra të kërkuarit është rrjedhim i vetëm një elementi, që lidhet me kriterin e pasurisë.
- 6.3. *Parimit të proporcionalitetit*, pasi marrja e masës ekstreme të shkarkimit nga detyra, duke u lidhur vetëm me faktin e pasaktësisë për mënyrën e deklarimit të kursimeve *cash*, si dhe mosvlerësimi i rrethanave që kanë kushtëzuar këtë mosdeklarim janë elemente që bien ndesh me mënyrën sesi KPA-ja e ka kuptuar, interpretuar dhe më tej zbatuar parimin e proporcionalitetit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

7. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike

efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Kjo kompetencë kushtetuese e Gjykatës është reflektuar dhe detajuar në nenin 71 të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës çdo akt që cenon këto të drejta dhe liri, sipas kritereve të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji. Në këndvështrim të kësaj kompetence, Gjykata vlerëson kërkesat e individit kur ai pretendon se të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese janë cenuar nga një akt i pushtetit publik ose vendim gjyqësor.

8. Kolegji vëren se, referuar përmbajtjes së nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, Gjykata funksionon me dy kolegje. Neni F, pika 1, i Aneksit të Kushtetutës parashikon se KPA-ja është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të KPK-së, sipas Aneksit dhe ligjit. Kurse juridiksioni i Gjykatës në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual për kontrollin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit është i kufizuar nga juridiksioni që dispozitat e Kushtetutës dhe Aneksit të saj u kanë dhënë organeve të rivlerësimit (*shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, organet e rivlerësimit ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ai konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera (*shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Neni 179/b, pika 2, i Kushtetutës parashikon se procesi i rivlerësimit, që realizohet nga KPK-ja dhe KPA-ja, do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt ligjor, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit. Në këtë kuptim, të gjitha të drejtat procedurale kushtetuese, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, përfshirë edhe standardin e “gjykatës së krijuar me ligj”, Kushtetuta ua ka garantuar subjekteve të rivlerësimit, përmes procesit gjyqësor në KPA. Duke pasur parasysh kompetencat e KPA-së, si organi që kontrollon vendimmarrjen e KPK-së, Gjykata ka vlerësuar se ky proces kontrollon edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Për sa më sipër, si edhe në përputhje me qëndrimin që Gjykata tashmë ka mbajtur në shqyrtimin e kërkesave që kundërshtojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, juridiksioni i saj në

shqyrtimin e ankimit kushtetues individual për këto çështje është i kufizuar nga vetë Kushtetuta, ndaj pretendimet që kanë të bëjnë me vendimmarrjen e këtyre organeve, qofshin të natyrës kushtetuese, ku përfshihet e drejta për proces të rregullt, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në këtë Gjykatë. Subjektet e rivlerësimit nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës, nëpërmjet ankimit kushtetues individual, për pretendime ose kërkesa që i përkasin atij procesi, i cili, siç vlerëson edhe GJEDNJ-ja, ka natyrë përfundimtare brenda sistemit të brendshëm të ankimeve.

12. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kjo çështje nuk hyn në juridiksionin kushtetues për sa kohë që objekt i kërimit është rishikimi i vendimit të organeve të tjera kushtetuese, KPK-së dhe KPA-së.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.